REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:206374

Datë: 24.01.2020

Numri i dokumentit: 00781996

P. nr.580/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti,** me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.H., nga K-Deçan Gjakova, për shkak të kanosjes nga neni 181 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-DP në Gjakovë PP/II.nr.1165/2019 të dt.30.09.2019, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë 21.01.2020**,** në prani të Prokurorit të shtetit Mone Syla , mbrojtësit të akuzuarit av.Arbër Guta dhe të akuzuarit B.H., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli ndërsa përpiluar me datë 23.01.2020 këtë:

A K T GJ Y K I M

I akuzuari **B.H.,** nga K Deçan ,tani me banim në Prishtinë , data e lindjes..., në Gjakovë , i biri i H. dhe i nënës S. e gjinisë B., ka të kryer shkollën e mesme, student ,i gjendjes se dobët ekonomike, i pa punë , i pa martuar , shqiptar, shtetar i Republikës së Kosovës, numër personal...

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse :

- **me dt.31.08.2019 , rreth orës 09.30 min , në Gjakovë ,RR. "T." ,** me qëllim të frikësimit dhe shkaktimit të ankthit , seriozisht e kanos personin zyrtar në lidhje me punën e tij – zyrtarin policor, këtu të dëmtuarin Sh.J., në atë mënyrë që derisa i dyshuari kishte qenë duke drejtuar veturën e tij "Golf" me targa të regjistrimit ...,, ndalohet nga policia për shkak të vozitjes së shpejtë dhe në momentin kur ndaj të njëjtit shqiptohet gjoba dhe njoftohet se do t'i konfiskohet patentë shoferi , i dyshuari pasi kundërshton këtë , i drejtohet të dëmtuarit me fjalët " *hiq s'ma nin për ju dhe hajt se ki mem marr vesh ti mu* "duke drejtuar gishtin tek i dëmtuari dhe me fjalët "*hajt se shihemi* ", me ç 'rast me këtë veprim të dëmtuarit, i shkakton frikë dhe ankth .

-me çka ka kryer veprën penale të kanosjes nga neni 185 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në mbështetje të nenit 4, 7, 17 par.1, 38 , 40, 42, 44, 69, 70, 71 , 72 dhe nenit 181 par.3lidhur me par.1 të ë KPRK-ës dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarin e :

G J Y K O N

DËNIMIN ME BURGIM në kohëzgjatje prej 90(nëntëdhjetë) ditëve.

2019:218600

Me kërkesën dhe pëlqimin e mbrojtësit dhe të akuzuarit, konform nenit 47 të KPRK-së, Dënimi me burgim prej 90(nëntëdhjetë) ditëve**.** të akuzuarit B.H. , **I ZËVËNDËSOHET ME DËNIM ME GJOBË në shumën prej 1000 (njëmijë) €uro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.**

Nëse i akuzuari B.H. , nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën e zëvëndsuar të dënimit me burg në shumë prej **1000 (njëmijë) €uro**, sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së ,atëherë i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim burgimi ne kohëzgjatje prej **50 (pesëdhjetë) ditësh** ,duke llogaritur për çdo ditë burgu prej **20**,- **€(njëzetë)euro .**

Detyrohet i akuzuari, që të paguaj në emër të programit kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 30,oo€, si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20,oo €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr.1165/2019 të dt.30.09.2019,, ka akuzuar të akuzuarin B.H., nga K-Deçan, për shkak të veprës penale të kanosjes nga neni 181 par.3lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjatë shqyrtimit fillestar me dt.21.01.2020, përfaqësuesi i PTH-DP në Gjakovë, Prokurorja Mone Syla, lexon aktakuzën PP/II.nr.1165/2019 të dt.30.09.2019 me ç 'rast i deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës.

I akuzuari B.H., duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se e pas konsultimit te mjaftueshëm me mbrojtësin e tij av Arber Guta, deklaroi se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimit te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se me pranimin e fajësisë në çdo fazë te procedurës jam penduar për kryerjen e kësaj vepre ne afekt për çka edhe pas përdorimit te fjalëve menjëherë i kam kërkuar falje të dëmtuarit për veprimet e mija ,edhe sot para gjykatës kërkojë falje nga i dëmtuari duke mos pasur për qellim qe te njëjtit ti shkarkoje ankth apo qellim sepse fjalët e mija kanë qene ne afekt ,premtojë se një veprim i tillë nuk do te përsëritet dhe në të ardhmen do të jem me i kujdesshëm . Andaj i propozoi gjykatës që të merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimin e fajësisë, kërkim falja para gjykatës për veprën e kryer, premtimin se ne te ardhmen do te jem me i kujdesshëm, gjendjen e dobët ekonomike si dhe faktin se është hera e parë qe kam ra ndesh e ligin te me shqiptojë një dënim me te butë.

Mbrojtësi i te akuzuari av.Arbër Guta deklaroi e mbështet ne tërësi pranimin e fajësisë nga i mbrojturi im , me qene se një pranimi i fajësisë është bere konform dispozitave ligjore te nga neni 248 i KPPK-ës, pas konsultimit te mjaftueshëm me ç 'rast i janë shpjeguar te gjitha favoret dhe pasojat e pranimit te fajësisë , andaj i njëjti ne mënyrë vullnetare e ka pranuar fajësinë , kështu qe i propozoi gjykatës qe një pranim te tillë te aprovojë. I propozoi gjykatës qe me rastin e caktimit te llojit dhe lartësisë se dënimit te këtë parasysh te gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato renduese nëse gjenë , me ç 'rast nëse gjykata vlerëson se është adekuate te shqiptojë një dënim me burgim i njëjti mundësisht ti zëvendësohet me dënim me gjobë dhe atë sipas kërkesës dhe pëlqimit te akuzuarit .

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari Prokurori i shtetit Mone Syla,deklaron se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuarit ,pasi qe pranimi i fajësisë është bere ne pajtim me dispozitën e nenit 248 te KPPK-ës si dhe pas konsultimit te mjaftueshëm me mbrojtësin e tij , gjithashtu pranimi ka mbështetje te plote ne provat te cilat

2019:218600

gjenden ne shkresa te lendes andaj i propozoi gjykatës gjykata te aprovojë pranimin e fajësisë si shprehje te lirë te vullnetit dhe me rastin e caktimit te llojit te lartësisë se dënim ti vlerësojë te gjitha rrethanat lehtësues dhe renduese e posaçërisht faktin se kem te bëjmë me veprën penale te kryer ndaj personit zyrtar,poashtut të obligohet ne pagesën e shpenzimeve procedurale.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari B.H.: **me dt.31.08.2019 , rreth orës 09.30 min , në Gjakovë ,RR. "T." ,** me qëllim të frikësimit dhe shkaktimit të ankthit , seriozisht e kanos personin zyrtar në lidhje me punën e tij – zyrtarin policor , këtu të dëmtuarin Sh.J., në atë mënyrë që derisa i dyshuari kishte qenë duke drejtuar veturën e tij "Golf" me targa të regjistrimit ...,, ndalohet nga policia për shkak të vozitjes së shpejtë dhe në momentin kur ndaj të njëjtit shqiptohet gjoba dhe njoftohet se do t'i konfiskohet patentë shoferi , i dyshuari pasi kundërshton këtë , i drejtohet të dëmtuarit me fjalët " *hiq s'ma nin për ju dhe hajt se ki mem marr vesh ti mu* "duke drejtuar gishtin tek i dëmtuari dhe me fjalët "*hajt se shihemi* ", me ç 'rast me këtë veprim të dëmtuarit, i shkakton frikë dhe ankth .

Gjykata nga të cekurat me lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarin formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 69 dhe 70 të KPK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethanë rënduese gjykata e konsideron faktin se i akuzuari ka kryer veprën penale të kanosjes nga neni 181 par.3 lidhur me par..1 të KPRK-së, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit, sjelljen e tij para kryerjes së veprës penale ka qenë korrekte, i pa punë , student dhe asnjëherë më parë nuk ka ra ndesh me ligjin, nuk ka qenë i dënuar. Në këtë drejtim ka ndikuar veçanërisht personalitetit i tij qe te gjykata është kuptuar si njeri i sjellshëm, korrekt, i urtë dhe i vetëdijshëm për veprën e kryer, është penduar thellë për veprën penale të kryer . Ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata vlerësoi pranimin e fajësisë nga i akuzuari në çdo fazë të procedurës penale, shprehjen e keq ardhjes për veprën e kryer, të cilat rrethana ndikuan qe gjykata ti zbatoj dispozitat e zbutjes se dënimit te parapara ne nenin 72 par 1 nën.par.1.6 te KPRK-ës, gjykata te akuzuarit i shqiptojë dënim me burgim ne kohëzgjatje pre 90 (nëntëdhjetë) ditësh, me të cilin dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 të KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij ,do të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Pas shpalljes së aktgjykimit, me kërkesën dhe pëlqimin e të akuzuarit A.K., Gjykata në kuptim të dispozitës të nenit 44 të KPRK-së, dënimin e shqiptuar me burgim e ka zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej 1.000 (njëmijë) euro, me pëlqimin e personit te dënuar.

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marr komfor nenit 463 par. 2 të KPPK-së

Vendimi mbi shpenzimet procedurës penale dhe atë në emër të paushalli gjyqësor në shumë prej 20,oo € është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.6 të KPPK-së. ndërsa për

2019:218600

programin për kompensimin e viktimave të krimit në shumë prej 30.oo € është marr konform nenit 39 par.3 nën.par.3.1 të Ligjit Nr. 05/L-036. për kompensimin e Viktimave të Krimit

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.580/19 më datë 21.01.2020.

Sekretarja juridike, **Gj y q t a r j a,**
Flutur Nagavci **Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh,** nga dita e marrjes së tij ne dorëzim ,Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.

2019:218600